



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 78, Datë 14.04.2025

MBI

**DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË
SHOQËRISË “M.C. ENERGJI GOJAN” SH.P.K. SI MJET PËR GARANTIMIN E
DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 9, pika 8, dhe 10, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.04.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 169/13 prot., datë 11.04.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “M.C. ENERGJI GOJAN” sh.p.k. për dhënie e autorizimit nga Enti Rregullator i Energjisë për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

Konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënie e autorizimit për shoqërinë “M.C. ENERGJI GOJAN” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si më poshtë vijon:

1. Kërkesa për Marrjen e Autorizimit

- Shoqëria “M.C. ENERGJI GOJAN” sh.p.k. është e licencuar nga ERE në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Gojan”, me kapacitet të instaluar 15 MW, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 276, datë 13.12.2024.
- Me shkresën nr. 169 prot., datë 16.01.2025, shoqëria paraqiti aplikimin për marrjen e autorizimit për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj palës kredidhënëse “Banka OTP Albania” sh.a.

2. Shqyrtimi i Kërkesës dhe Kërkesa për Dokumentacion Plotësues

- Gjatë shqyrtimit të kërkesës, ERE, me shkresat nr. 169/1 prot., datë 30.01.2025, nr. 169/4 prot., datë 18.02.2025 (e-mail rikujtesë), dhe nr. 169/7 prot., datë 25.02.2025, ka vënë në dukje mungesën e dokumentacionit të nevojshëm dhe ka kërkuar plotësimin e tij nga shoqëria.
- Në vijim, shoqëria ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar me shkresat nr. 169/5 prot. dhe nr. 169/6 prot., datë 20.02.2025, si dhe nr. 169/8 prot., datë 06.03.2025.
- Nga verifikimi rezulton se shoqëria “M.C. ENERGI GOJAN” sh.p.k. nuk ka detyrime të prapambetura financiare ndaj ERE-s.

3. Vlerësime dhe Kushtet për Dhënien e Autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve **nuk e përjashton shoqërinë nga detyrimi për të marrë autorizime/miratime nga organet apo institucionet e tjera përkatëse**, në rast se kjo kërkohet prej tyre.
- Në referencë të **nenit 9, pika 8**, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 235, datë 26.11.2022, **shoqëria është e detyruar të dorëzojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga momenti i reflektimit në të i vendosjes së kolateralit** mbi kuotat e saj.
- Duke pasur parasysh natyrën e vendosjes së barrës siguruese mbi kuotat, e cila ndikon drejtpërdrejt në kontrollin e interesave të subjektit të licencuar, vlerësohet e nevojshme që **shoqëria të detyrohet të njoftojë menjëherë ERE-n në rast të heqjes së kësaj barre ose në rast të një ekzekutimi të detyrueshëm.**

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit për vendosjen e kuotave të shoqërisë “M.C. ENERGI GOJAN” sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga “Kontrata e Kredisë” nr. 5045 rep., nr. 1262 kol., datë 20.12.2024, e lidhur ndërmjet “Banka OTP Albania” sh.a., në cilësinë e kredihënësit, dhe shoqërisë “M.C. ENERGI GOJAN” sh.p.k., në cilësinë e kredimarrësit..
2. Dhënia e Autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “M.C. ENERGI GOJAN” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet përkatëse nga organet ose institucionet e tjera, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria “M.C. ENERGJI GOJAN” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj.
4. Shoqëria duhet të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.
5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
6. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “M.C. ENERGJI GOJAN” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI